



KOMUNA E RAHOVECIT



SHODPRONEBITSHA

KOMUNA E RAHOVECIT / RAHOVEC MUNICIPALITY / RAHOVEC
KABINETI I KRYESARIT / COUNCIL OF THE MUNICIPALITY / CABINET
KABINETI I KRYESARIT E ALBANIËS / COUNCIL OF THE PRESIDENT OF THE MUNICIPALITY ALBANIA / CABINET


Njësia Nr./Br./No 02/Kabinet i Kryesarit të Komunës

Nr./Br./No 736 N. 1189/Br.str./No.pr. 74

Data/Datum/Date 02/06/2020

RAHOVEC / DRAHOVAC

BULETINI MUJOR KOMUNAL MAJ 2020



PËRMBAJTJA

HYRIE	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE.....	2
PËRFUNDIM.....	14

HYRJE

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtoreve përgjatë muajve të vitit 2020, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Edhe muaji maj i vitit 2020, është karakterizuar me një sërë aktivitetesh, pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, situatë kjo e cila ka sjellur mjaft vështirësi edhe në Komunën e Rahovecit.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin maj, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet nga ana e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtoreve në Komunën e Rahovecit.

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE

Në kujtim të 12 majit, ditës së dëshmorëve në komunën e Rahovecit, Kryetari, z.Smajl Latifi me bashkëpunëtorë, përfaqësues të OVL, UÇK-së dhe familjarë të të rënëve për liri, kanë bërë nderime dhe homazhe në kujtim të atyre që dhanë mundin, djersën dhe jetën e tyre në etapa të ndryshme historike.

LAVDI!



Me nënën Bademe, djalin Seprandin, vajzën Brikenën, bashkëluftëtarë e bashkëpunëtorë, Kryetari Laitifi nderoi kujtimin, veprën dhe rënien heroike të veprimtarit të shquar të ilegales atdhetare, bashkëthemeluesin e celulave të para të UÇK-së në Anadrini, eprorin e UÇK-së i sprovuar në organizim, riorganizim dhe në beteja, Bedrush Gashin nga Drenoci.

LAVDI!


Kanë filluar punimet për ndërtimin e parkut në fshatin Zaqisht, projekt ky i cili është në kuadër të projekteve që ka Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për ndërtimin e tetë parqeve në komunën e Rahovecit. Shtimi i hapësirave të gjelbëruara është një nga priorititetet e Komunës së Rahovecit, duke mundësuar kështu që qytetarët të pushojnë dhe kalojnë kohë më shumë në mjedis të hapur.



Kryetari, z. Smajl Latifi me familjarë, bashkëluftëtarë e bashkpunëtorë, në 22-vjetorin e përjetësimit të tij në Gexhë, nderuan kujtimin për heroin MEHEDIN MORINA nga Gilareva e Klinës.

LAVDI!

I shoqëruar nga drejtori i Bujqësisë, z. Berat Duraku, Nënkyetari, z. Fatmir Iska dhe kolegë bashkpunëtorë, Kryetari Latifi ka pritur në takim Ministrin në detyrë të Bujqësisë, z. Besian Mustafa, të cilin e informoi për gjendjen e krijuar në komunën e Rahovecit si pasojë e pandemisë COVID-19, me theks të veçantë me vështirësitë që po ballafaqohen fermerët tanë, të cilët nuk kanë treg se ku t'i shesin produktet e tyre. Poashtu, shprehën kërkesën që të futen fermerët në pakon emergjente për shkak të humbjeve, sikurse edhe për plot aspekte të tjera të cilat nëpërmes kësaj Ministrie, do të mund t'i zgjidhnim.



Në 21 vjetorin e zhdukjes pa gjurmë të profesorit Ukshin Hoti, në Krushë të Madhe është mbajtur një akademi përkujtimore virtuale.



Rrebeshet intensive, vërshimet përsëri kanë përfshirë komunën e Rahovecit. Zonat më të prekura nga breshëri dhe vërshimet janë: Zaqishti, Retija, Hoça e Vogël, Brestoci, Opterusha, Nagaci dhe Krusha e Madhe. Me vendimin e Kryetarit, z.Smajl Latifi, janë formuar pesë komisione të veçanta të vlerësimit, pasi që dëmet më të mëdha janë në bujqësi si dhe në amvisëri.

Bashkë me kolegë bashkëpunëtorë dhe Ministrin në detyrë të Bujqësisë, z. Besian Mustafa, Kryetari Latifi ka vizituar zonat më të prekura nga rrebeshet intensive, breshri dhe vërshimet, ku bashkë me Ministrin në detyrë, z.Besian Mustafa u dakorduan që Qeveria domosdo të mbështesë fermerët dhe t'i u ofrojë mbështetje institucionale konkrete me aq kapacitete sa ka.



Kryetari Latifi, para anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, ka analizuar gjendjen e përgjithshme të sigurisë e cila është e qetë dhe stabile, për dëmet dhe pasojat e reshjeve intensive të shiut dhe breshrit, për anagazhimin që po bëhet për evidetimin dhe vlerësimin financiar të tyre, poashtu ka paraqitur Informatën rreth gjendjes momentale me COVID - 19, si dhe për veprimet dhe masat e shumta për më shumë se 2 muaj i ka ndërmarrë Shtabi i Posacëm Emergjent në Komunën e Rahovecit për menaxhimin e situatës me COVID-19.



Kryetari Latifi, i shoqëruar nga Drejtori i Shërbimeve Publike Përparim Krasniqi, kanë qëndruar në Marmull të Gjakovës, për të parë nga afër punimet për sanimin e defektit në gypin e ujit të pijshëm.





Në 21 vjetorin e rënies heroike të dëshmorëve të lirisë, Milaim Morina dhe Xhevdet Krasniqi, në afërsi të Celinës, Kryetari Latifi së bashku me bashkëpunëtorë, familjarë të të rënëve për liri dhe përfaqësues të OVL të UÇK-së, kanë bërë homazhe në kujtim të veprës dhe sakrificës sublime për lirinë e atdheut.


LAVDI!

Me rastin e 22 vjetorit të rënies heroike në fushë të nderit të Heroit të Kombit, luftëtarit të orëve të para, Feim Gashi nga Drenoci, të dëshmorëve të lirisë, Përparrim Thaçi nga Landovica dhe Sakip Bellaqa nga Pataqani i Epërm, Kryetari, z.Smajl Latifi bashkë me familjarë, me NËNËN HEROINË të FEIMIT e BEDRUSHIT, NËNËN BADEME, me bashkëpunëtorë e bashkëluftëtarë, kanë bërë homazhe në vendin ku ata ranë në pritën armike, ndërmjet Fortesës dhe Xërxës.

LAVDI!



Edhe përkundër të gjitha përgatitjeve për hapjen e tregut, tregu nuk është lejuar të hapet dhe fermerët e komunës sonë nuk janë lejuar të shesin prodhimet e tyre. Edhe pse është siguruar hapësira mes 6 metra distancë mes tezgave për shitje, poashtu Inspektorati Komunal bashkë me Stacionin Policor në Rahovec dhe gjithë stafin e DBPZHR-së, do të monitoronin gjendjen dhe shitjen e produkteve nga fermerët, kjo nuk është lejuar të bëhet dhe ka shkaktuar pakënaqësi të mëdha nga fermerët tanë. DBPZHR, dhe Komuna e Rahovecit u ka bërë thirrje organeve kompetente të reflektojnë, dhe fermerëve tanë të ju mundësojnë hapjen e tregut sa më shpejtë që është e mundur në të kundërtën dëmet do tëjenë të mëdha dhe e pamundur të kompensohen.



Rrugët vreshtare për ditë e më shumë po rregullohen!

Kanë filluar punimet në segmentin rrugor: Nushpallë - Vrajakë - Ratkoc i gjatë 4,600 metra. Ky investim është duke u financuar nga Ministria e Bujqësisë.

Edhe në Senoc rrugët fushore janë duke shkuar drejt përfundimit.



Drejtoria e Bujqësisë, është duke i vizituar të gjithë fermerët të cilët prodhimet e tyre nuk kanë mundur ti shesin si shkak i pandemisë COVID-19. Në bazë të të dhënavë të grumbulluara do të përpilojë një raport të detajuar, të cilin do ta dërgojë në MBPZHR-në, ku do të kërkohet kompensimi i këtyre dëmeve të shkaktuara.



Pos dëmeve në Bujqësi, kemi dëme të konsiderueshme edhe në infrastrukturë publike.

Inxhinierët dhe stafi i Drejtorisë së DSHP-së vizituan disa lagje të qytetit dhe vendbanimeve që kanë pësuar dëme pas reshjeve të shumta.

Kanë filluar punimet për ndërtimin e rrugës në relacionin: Rahovec - Pataqan i Ulët, projekt ky i një rëndësie të veçantë sa i përket infrastrukturës rrugore, sepse krijon kushte më të mira të qarkullimit dhe lëvizjes së qytetarëve.



Lagja e ndriçuar në rrugën "Eshrafedin Kastrati" në Rahovec.

Ndriçimi publik në rrugën "Halim Hoti" në fshatin Krushë e Madhe!



Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen "Hamza" në Rahovec dhe ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen "Popaj" në Fortesë!



Po vazhdon eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave, pamjet janë në fshatin Nagac.

Drejtori i DSHP-së, ka falënderuar Drejtorinë e Bujqësisë që në bashkëpunim me kompanitë e kontraktuar nga Komuna, që janë në proces të rregullimit të rrugëve fushore, kanë bërë edhe eliminimin e kësaj deponie të mbeturinave.



Vazhdon mirëmbajtja e varrezave në tërë territorin e komunës së Rahovecit!



Drejtori i DSHPS-së, z. Samir Mustafa së bashku me Drejtorin e QKMF-së, Dr .Jusuf Korenica vizituan Objektin e Emergjencës ku panë nga afër dinamikën e punimeve dhe u informuan nga Operatori Ekonomik që objekti është drejt finalizimit dhe shumë shpejt pritet të bëhet përrurimi i objektit.



Për herë të dhjetë është bërë dezinfektimi i objekteve shëndetësore në Komunën e Rahovecit. I ftojmë qytetarët që gjatë vizitës së tyre në Qendrat e Mjekësisë Familjare t'i respektojnë rregullat e IKSHP-së.

Janë duke vazhduar me intensitet të shtuar, punimet në Shtëpinë e Kulturës në Ratkoc, besojmë që shumë shpejtë do përfundohet edhe riparimi i këtij objekti, i cili është shumë i rëndësishëm përfaktin se një gjë e tillë është e nevojshme përf të rinjtë tanë, sidomos për komunitetin artistik.



Ka filluar restaurimi i Mullirit të familjes Hoxha, i cili është i vjetër afro 300 vite, dhe njihet si "Mulliri i Hoxhajve", i njëjtë ka shërbyer përf nevojat e familjes, si dhe ka qenë funksional para shumë vitesh. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe vlerat që i posedojnë monumente të tillë të cilët nuk janë të paktë në komunën e Rahovecit, ne si institucion kemi marr një hap të rëndësishëm drejt ruajtjes dhe mbrojtjes së monumenteve me rëndësi të veçantë historike, krahas restaurimeve të cilat janë bërë, ndër ta është dhe ky mulli i cili ka filluar të restaurohet.







Ka vazhduar restaurimi i "Bunarit të Madh" në fshatin Ratkoc, i cili për banorët e këtij vendi ka një rëndësi të veçantë historike. Poashtu, me intensitet të lartë, kanë vazhduar edhe punimet në fushën sportive në fshatin Dejnë.



Lapidari në oborrin e shkollës filllore në fshatin Guri i Kuq kushtuar 17 martirëve të rënë me 31 mars 1999. Projekti i lapidarit është realizuar në bashkëfinancim ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe banorëve të fshatit. Përurimi zyrtar do të bëhet më 14 qershor, në Ditën e Çlirimtë të Rahovecit.



10 MIJË DRUNJ PËR

RAHOVECIN - Një projekt serioz që do t'ia ndryshojë pamjen për të mirë komunës së Rahovecit, ka nisur sot. Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka nisur së zbatuari projektin për mbjelljen e drunjve të llojeve të ndryshme, si Rrap, Bli, Catalpa etj, sipas së cilët parashihet mbjellja e mbi 10 mijë drunjve në tërë territorin e komunës sonë.

Kanë vazhduar me intensitet të shtuar punimet në ndërtimin e objektit të çerdhes për fëmijë në Xërxë. Drejtori i DKA-së Avni Morina, bashkë me mbikëqyrësin e punimeve ishin përvizitë dhe panë nga afér securinë e punës.





Edhe në objektin e ri të shkollës "Sadedin Hajda" në qytet, këto ditë është rritur intensiteti i punimeve. Po vazhdon fasadimi i jashtëm i mureve të objektit.

Drejtori i DKA-së vizitoi objektin e çerdhes për fëmijë që po ndërtohet në Ratkoc, ku pas montimit të dritareve ka përfunduar edhe faza e parë e instalimit të kabllove të rrjmës elektrike. Së shpejti do të fillojë puna në suvatinin dhe fasadimin e mureve. Është ky një investim mjaft i rëndësishëm i komunës sonë për fëmijët tanë.



Ka filluar pajisja me inventar në Çerdhen e Re "Tulipanët" në qytet. Drejtori i DKA-së me zyrtarin e arsimit Admirim Durguti dhe drejtoreshën e çerdhes Brikena Osa, ishin te objekti i ri i çerdhes, ku ka filluar furnizimi me inventarin e nevojshëm.



Ka vazhduar puna në terren e komisioneve të formuara me vendim të kryetarit të komunës z. Smajl Latifi. Zyrtarët komunal kanë shikuar nga afër çdo parcelë të démtuar duke grumbulluar të dhënat për kulturat bujqësore. Drejtori i Bujqësisë ka parë nga afër punën e komisionit duke takuar edhe fermerët e démtuar.

Është duke vazhduar monitorimi dhe mbledhja e të dhënave në secilën parcelë me kultura të ndryshme bujqësore, ku si pasojë e fatkeqësive natyrore kanë pësuar dëme të konsiderueshme edhe disa zona vreshtare në Komunën e Rahovecit.



Zonat vreshtare të fshatrave: Drenoc, Senoc, Pastasel dhe Vrajakë janë në gjendje mjaft të mirë, pasi që deri më tanë nuk kemi pasur fatkeqësi natyrore në këto pjesë. Për të parë nga afër gjendjen e këtyre vreshtave, drejtori Berat Duraku ka vizituar disa nga zonat e fshatrave ku ka të mbjella sipërfaqe të konsiderueshme me hardhi të rrushit. Sipas informatave që i kemi marrë në teren, gjendja e vreshtave është mjaft e mirë, duke pasur parasysh që kemi pasur reshje të mëdha të shiut dhe breshrit.

Si pasojë e të reshurave të mëdha të shiut dhe breshrit, komuna e Rahovecit është goditur në masë të madhe ku janë dëmtuar shumë kultura bujqësore. Me vendim të Kryetarit të Komunës, z. Smajl Latifi janë formuar edhe katër komisione vlerësuese të dëmeve të shkaktuara në bujqësi nga breshri, reshjet e rrëmbyeshme të shiut dhe përblytjet, me 19 dhe 20 maj, ku përfshihen edhe dëmet nga reshjet e vazhdueshme të ditëve në vijim pas këtyre datave. Në raportin e përgatitur nga komisioni për vlerësimin e dëmeve, është paraqitur në mënyrë të përgjithësuar: sipërfaqja e dëmtuar, rendimenti i pritur për secilin sektor si dhe vlera e dëmit të shkaktuar e që në total kap shumën: 2,641,100.88€. Komuna e Rahovecit, poasjtu ka bërë kërkësë për dëmshpërblim të dëmeve që u janë shkaktuar fermerëve, nga breshëri dhe vërshimet. Kërkesa është parashtruar kundrejt Kryeministrit në detyrë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti dhe Ministrit në detyrë të MBPZHR-së, z. Besian Mustafa, ku edhe kemi kërkuar që të ndahet buxhet për t'ju dal në ndihmë fermerëve punëtorë të komunës sonë.



Kryetari, z.Smajl Latifi, me bashkëluftëtarë e miq bënë homazhe në kujtim të dëshmorëve të lirisë: Besim Kabashi, Jeton Kabashi, Bujar Thaçi dhe Selim Berisha, në "Lugjet e Verdhë" të Rahovecit dhe në Brestoc, aty ku ata tanimë kanë shtëpinë e amshueshme. LAVDI!



Në kujtim dhe nderim të sakrificës sublime për lirinë e Atdheut, Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë, familjarë të të rënëve për liri dhe përfaqësues të OVL UÇK-së në Rahovec, bënë homazhe në Hamoc, ku prehen djemtë më të zotët e këtij populli, dëshmorët: Sadedin Hajda dhe Mexhit Mustafa. LAVDI!

Kryetari, z. Smajl Latifi ka pritur në një takim pune z. Bislim Zogaj, Drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale. Në takim u bisedua edhe për mundësinë e ngritjes së një Muzeu në Krushë të Madhe, sepse duke ngritur vepra të tillë monumentale i japim kuptim sakrificës së njerëzve dhe vetë vlerës së lirisë.



Në nderim të veprës madhore të dëshmorëve të rënë në betejën e "Mileskes", heroi Mensur Zyberaj-Komandant "500" nga Drenoci i Rahovecit, Ismail Gashi nga Krusha e Madhe, Habib Gashi nga Nagaci, Kurtish Hasani nga Qëndresa e Prizrenit dhe Bedri Berisha nga Volljaka e Klinës, Kryetari, z.Smajl Latifi bashkë me familjarë, bashkëpunëtorë dhe përfaqësues të OVL, UÇK-së, kanë bërë nderime dhe homazhe, pranë lapidarit përkujtimor te lëndina e trimave, në trekëndëshin që lidh vendbanimet: Nagac, Krushë e Madhe dhe Qëndresë (Randobravë).



Sinjalizimi i rrugës në pikën turistike, në drejtim te Maja e Shkodranit ne Rahovec.



Vazhdojnë punimet për ndërtimin e shtegut të ecjes "LULET E MARSIT", në Krushë të Madhe.

PËRFUNDIM

Ky buletin përbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe: (maj 2020).

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendoror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtyj dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjeter përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Vërejtje: *Lista e vendimeve të marra nga ana e Kryetarit të Komunës, është publikuar, veçmas dhe të gjitha vendimet e listuara, mund t'i gjeni në ueb faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit.*

Rahovec, 2 qershor 2020